



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4922 prot.

Himarë, më 02.07.2025

VENDIM

Nr. 26 , Datë 27.06/2025

PËR

“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJEÇAR, NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 5 HA, NR.PASURIE 2/78 , ZK:3844 NË FAVOR TË SHOQËRISË “SOLEIL&SEA”SH.P.K.”

AKTIVITETI:

“SHFRYTËZIM PËR PARKIM TË AMBJENTIT PËR MAKINERITË E INERTEVE, PËR NEVOJA TË KOMPANISË”

Bazuar ne ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, ligjin 57/2020, date 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 5; VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”; V.K.M-në nr.888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë këshilli bashkiak pasi shqyrtoi materialin e miratoi me gjashtëmbëdhjetë (16) vota pro , tre (3) kundër , zero (0) abstenim dhe si më poshtë ,

VENDOSI:

1.Dhënie e miratimit për fillimin e procedurave dhënie në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullor të një sipërfaqe prej 5 HA, NR.PASURIE 2/78 , ZK:3844 në favor të

shoqërisë "SOLEIL&SEA"SH.P.K." për aktivitetin "Shfrytëzim për parkim të ambjentit për makineritë e inerteve, për nevoja të kompanisë".

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për ngritjen e urdhrave përkatës për zbatimin dhe ndjekjen e të gjithë hapave proceduralë ligjorë të këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

